



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 35, datë 26. 05. 2022

PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” I SKRAPARIT  
Z. MUHARREM BAZE

Këshilli Bashkiak Skrapar, në mbledhjen e datës 26.05.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Z. Adriatik Mema, mbështetur në Ligjin Nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjin Nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, neni 14, 15 pika 1/a, 2/b, neni 16 dhe vijues,

VENDOSI:

1. Dhënie e titullit “Qytetar Nderi” i Skraparit Z. Muharrem Baze me motivacionin: *“Në vlerësim të kontributit të tij të shquar në zhvillimin dhe masivizimin e futbollit në Skrapar, këtij sporti aq të dashur për të gjithë. Trajner i suksesshëm i ekipit “5 Shtatori”, që me përkushtimin dhe punën e tij të palodhur sëbashku me futbollistët e talentuar që ka stërvitur, e ngritën këtë ekip në nivelet më të larta të kohës duke e bërë të njohur në të gjithë Shqipërinë”.*
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Skrapar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi u miratua me 12 vota por, vota kundër – s’ka, vota abstenim – s’ka.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut.



KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

